




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 444, datë 26.6.2019

P Ë R

**MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN
NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR DHE TË MASËS SË MBULIMIT TË ÇMIMIT
TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 37, të ligjit nr.105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, dhe të pikave 2, shkronja "b", e 6, të nenit 10, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës I të barnave të rimbursueshme, që tregtohen në farmacitë e spitaleve, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e listës II të barnave, që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Miratimin e masës së mbulimit të çmimeve të barnave të rimbursueshme, të renditur sipas klasifikimit ATC, në masën 50% - 100%, sipas grupeve terapeutike dhe barnave të dhëna në pasqyrën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Miratimin e marzheve të tregtimit për barnat e listës së rimbursueshme, përkatësisht në masën 8% e 24%, për tregtimin me shumicë dhe tregtimin me pakicë.
5. Miratimin e marzheve të diferencuara të tregtimit me shumicë dhe me pakicë të disa barnave të listave I dhe II, të përcaktuara në pasqyrën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të përcaktojë kufizimet në përdorimin, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit me barnat e kësaj liste.
7. Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të lidhë marrëveshje për reduktimin e çmimit të përcaktuar në këtë vendim me mbajtësit e autorizimit për tregtim, me miratimin e Këshillit Administrativ.
8. Nëse gjatë periudhës kur ky vendim është në fuqi ulen çmimet për barnat e paregjistruara të listës ose barnat alternativë e vetme, që tregtohen në farmacitë e spitalit dhe farmacitë e rrjetit të hapur, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me njoftimin e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, reflekton uljen e çmimit të barit në listë. Pulla e kontrollit të barit do të lëshohet pas miratimit të çmimit nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2019.
10. Vendimi nr.218, datë 20.4.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, i ndryshuar, shfuqizohet.
11. Ngarkohen Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i fillon efektet e tij në datën 1 korrik 2019.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

OGERTA MANASTIRLIU